



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën d. nenit 17 paragrafi 1 nën f) nenit 40 paragrafi 2 nën paragrafi nën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 4 të Statutit të Komunës, me kërkesën e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të rregullt për vitin 2015, të mbajtur më 20.07.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin e Planeve të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve

I

Miratohen Planet e Veprimit për përmirësimin e Shërbimeve:

1. Mbrojtja e Mjedisit-Menaxhimi i mbeturinave
2. Ndriçimi Publik

II

Projekti për Menaxhimin e mbeturinave, ul nivelin e ndotjes nga mbeturinat dhe ka synim drejt menaxhimit efikas të tyre.

Ky projekt financohet nga USAID në bashkëfinancim me Komunën në shumë prej 45 mijë Euro.

III

Projekti i Ndriçimit publik ndikon në rritjen e sigurisë së qytetarëve sidomos të nxënësve.

Ky projekt financohet nga USID në bashkëfinancim me komunën në shumë prej 22 mijë Euro.

IV

Këtij vendimi i bashkëngjiten edhe dy kopje të Planeve të Veprimit.

Ky vendim është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi i Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal konform nenit 81 të LVL.

V

Me këtë vendim të njoftohen: MAPL-Prishtinë, Kryetari i Komunës, Drejtoria gjegjëse, Shërbimi për punë të Kuvendit, Zyra Ligjor, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

